



Planuar / Doretuar Priljeft/Prodato Received/Delivry	12.12.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTOK	7950/2022		119



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.911/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Flakron Gashi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.911/2022 të datës 14.10.2022, të parashtruar nga ankuesi, me adresë kundër Vendimin Nr.1010 të datës 04.10.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "ri sistemin", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 12.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.911/2022 e datës 14.10.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Anullohet Vendimi Nr.1010 i datës 04.10.2022 i Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit duke kthyer ankuesin në pozitën e punës Udhëheqës i Njesisë Ekonomike, sipas Akt Emërimit të datës 03.09.2012 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e tij e punës.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi nëpunës civil në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datë 14.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6176 të regjistruar nën shenjen A.nr.911/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.1010 të

datës 04.10.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me pretendimin ankimor se vendimi për ri sistemim është nxjerr përmes shkeljes thelbësore të dispozitave procedurale dhe shkeljes së ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 25.10.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa më datë 26.10.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin Nr.163 të datë 22.11.2022 ka vazhduar afatin e vendimmarrjen lidhur me këtë çështje ankimore edhe për dhjetë (10) dite pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, administroi këto prova: Ankesën me numër të protokollit 6176/2022 të datës 14.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër të protokollit 1010 të datës 04.10.2022; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 15.06.2012; Konkursin me numër reference MD/SHKK/40-20-06-2012 për pozitën "Udhëheqës i Njesisë Ekonomike"; Akt emërimit të datës 03.09.2012; Organogramin e Drejtorisë Qendrore të Burgjeve të Kosovës; Organogramin e Drejtoratit- Ekonomia e shërbimit Korrektues të Kosovës; Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale; Emalin e datës 29.09.2022 të drejtuar Emalin e datës 30.09.2022 të drejtuar Emalin e datës 29.09.2022 të drejtuar Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 6253/2022 të datës 17.10.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 6480/2022 të datës 26.10.2022; Rekomandimin për emërimi të datës 30.07.2012; Njoftimin me numër 242 të datës 02.08.2012; Raportin final të rekomandimit nga Komisioni Rekrutues të datës 30.07.2012; Formularin e të dhënave për listën e pagave të datës 06.09.2012; Vendimin për zgjatjen e afatit për vendosje me numër VK.nr.163/2022 të datës 22.11.2022 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Shërbimi Korrektues i Kosovës, me datë 21.06.2012 kishte shpallur konkurs publikë për rekrutimin e pozitës *Udhëheqës i Njesisë Ekonomike*, ku si rrjedhojë pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, ankuesi me datë 03.09.2012 kishte nënshkruar Aktin e Emërimit (me afat të pacaktuar - karrierës) për pozitën përkatëse të punës, me koeficient të pagës nëntë (9) dhe i njëjti kishte vazhduar të ushtroj këtë pozitë të punës deri me datë 04.10.2022, sipas përshkrimit të detyrave të punës të aprovuar nga organi përkatës i punësimit me datë 16.06.2012.

Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, me Vendimin Nr.1010 të datës 04.10.2022 ka risistemuar ankuesin nga pozita e punës *Udhëheqës i Njesisë Ekonomike* në Drejtorinë Qendrore të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Pune Juridike dhe të Përgjithshme* në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, me

koeficient të pagës tetë (8), me arsyetimin se Rregullorja QRK-Nr.31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë nuk parasheh Divizion apo Njësi Ekonomike, e as pozitë Udhëheqës i Njësisë Ekonomike.

Kundër Vendimit Nr.1010 të datës 04.10.2022 për ri sistemim, ankuesi me datë 14.10.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës dhe shkeljes së ligjit material, me pretendimin ankimore se i njëjti në pozitën e punës *Udhëheqës i Njësisë Ekonomike* është zgjedhur sipas konkursit publikë dhe rrjedhimisht me datë 03.09.2012 ka nënshkruar akt emërimin me afat të pacaktuar – karrierës. Tutje, ankuesi pretendon se nuk ka pasur shuarje apo ristrukturim të institucionit, sepse Njësisë Ekonomike ka ekzistuar edhe me Ligjin Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, dhe ekziston edhe sipas dispozitave të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës (*i cili ka hyrë në fuqi me datë 24.08.2022*), përkatësisht nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9, ku përcaktohet se: 1. SHKK është përgjegjëse për: 1.9. zhvillimin e aktivitetit ekonomik dhe krijimin e të ardhurave përmes njësisë ekonomike të SHKK-së; si dhe nenin 16 (Njësia Ekonomike) ku përcaktohet se: 1. SHKK përmes njësisë përkatëse zhvillon aktivitete ekonomike, prodhuese, ofron shërbime, punëson të burgosurit dhe krijon të hyra për nevojat e SHKK-së me qëllim të risocializimit, plotësimin e nevojave të SHKK-së, uljen e kostos buxhetore të shpenzimeve. 2. Njësia ekonomike prodhon dhe përpunon produkte bujqësore dhe industriale nga punëtoritë e saj për nevojat e SHKK-së, produktet të cilat konsiderohen tepëricë i plason në treg. 3. Në bazë të aktivitetit ekonomik njësia krijon të hyra dhe këto të hyra i shfrytëzon për nevoja të Shërbimit Korrektues të Kosovës. 4. Të hyrat e realizuara nga aktiviteti ekonomik do të shpenzohen në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi. 5. Njësia Ekonomike, menaxhon me blerjet dhe shitjet, përgatit analiza për të hyrat nga institucionet përkatëse duke pasur për bazë kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore si dhe veprimtarive prodhuese. 6. Ministri i Drejtësisë me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm mund të lidhë marrëveshje me operatorë të ndryshëm ekonomikë sipas legjislacionit përkatës në fuqi. 7. Struktura organizative e Njësisë Ekonomike rregullohet me aktin nënligjor për organizimin dhe sistematizimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës, dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji i Këshillit konstatoi se Shërbimi Korrektues i Kosovës ndër të tjera është përgjegjës edhe për zhvillimin e aktivitetit ekonomik dhe krijimin e të ardhurave, ku sipas legjislacionin në fuqi kjo përgjegjësi ushtrohet përmes njësisë ekonomike, struktura organizative e të cilës rregullohet me aktin nënligjor për organizimin dhe sistematizimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, neni 10 paragrafi 2 përcaktohet se: 2. Organizimi i brendshëm dhe funksionimi i Shërbimit Korrektues të Kosovës, rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë sipas legjislacionit përkatës në fuqi, ndërsa me nenin 68 të njëjtit ligj përcaktohet se: 1. Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, nxirren brenda një (1) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji. 2. Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore sipas këtij Ligji zbatohen aktet nënligjore në fuqi, me kusht që mos të jenë në kundërshtim me dispozitat e këtij Ligji, andaj, duke marr parasysh konstatimin e organit të punësimit se Rregullorja QRK-Nr.31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë nuk përmban njësinë ekonomike në kuadër të strukturës organizative të Shërbimit Korrektues të Kosovës, Kolegji i Këshillit vlerëson se ky akt nënligjor nuk është në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin

Korrektues të Kosovës, dhe si i tillë nuk mund të prodhoj pasoja të dëmshme për ankuesin për derisa e drejta e ankuesit buron drejtpërdrejt nga ligji në fuqi për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Kështu që duke marr parasysh se me provat e administruara të lëndës është vërtetuar mjaftueshëm se ankuesi është i emëruar në pozitën e punës Udhëheqës i Njesisë Ekonomike në Shërbimin Korrektues të Kosovës, dhe meqenëse se me dispozitat e ligjit aktual është përcaktuar se Shërbimi Korrektues i Kosovës është përgjegjës edhe për zhvillimin e aktivitetit ekonomik dhe krijimin e të ardhurave përmes njesisë ekonomike, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimi ankimor i ankuesi për shkelje të ligjit material nga organi i punësimit me rastin e ri sistemimit të tij nga pozita e punës Udhëheqës i Njesisë Ekonomike në Drejtorinë Qendrore të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me koeficient të pagës nëntë (9), në pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Pune Juridike dhe të Përgjithshme në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, me koeficient të pagës tetë (8), është i bazuar dhe i drejtë, ndërsa Vendimi Nr.1010 i datës 04.10.2022 është i paligjshëm në kuptim të dispozitave të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit ankuesi ka të drejtë t'i ushtroj detyrat e punës sipas Aktit të Emërimit të datës 03.09.2012, deri në nxjerrjen e akteve nënligjore siç përcaktohet me dispozitat e nenit 16 paragrafi 7 dhe 8 dhe nenit 10 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, dhe rrjedhimisht deri në përfundimin e procesit të sistematizimit të vendeve të punës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.911/2022

Flakron Gashi

Procesmbajtës

Jeton KOÇA

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.